



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretarati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 13.5 pika (a) të Rregullores së Punës së KQZ-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 15.04.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për miratimin e projektit të SKQZ-së “Edukimi i votuesve të rinj”

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore të KQZ-së i datës 14.04.2009 për fillimin e procedurave të prokurimit/shpalljen e tenderit për realizimin e projektit të Departamentit të Operacioneve Zgjedhore të SKQZ-së “**Edukimi i Votuesve të Rinj**” për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009, sipas veçorive/specifikave të bashkangjitura këtij vendimi.
- II. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes i SKQZ-së që në afat sa më të shpejt të mundshëm të ndërmarrë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me datë 15 prill 2009.

Prishtinë, 15 prill 2009

per Zait Xhemajli

Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve